



Republika e Kosovës

Komuna e Rahovecit

Kabineti i Kryetarit



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVES / KOMUNA RAHOVEC / OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PREDSIEDIKA OPSTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 1605 Nr. i faq./Br.str./No.pg 325

Data/Datum/Date 1 / 3 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

LISTA E VENDIMEVE TË MARRURA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI: SHKURT 2022


Nr	Emri i vendimit	Nr. Protokollit
1	Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënie në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të komunës për drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit	NRP-02-1508-2022
2	Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr.02/1480, i datës: 24.01.2022	NRP-02-1510-2022
3	Vendim me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. Prot.02/1347/2021 i dt.20.12.2021	NRP-02-1511-2022
4	Vendim për caktimin e këshilli organizues për 17 Shkurtin-Ditën e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës	NRP-02-1513-2022
5	Vendim për caktimin e grupit punues për hartimin e Planit të vlerësimit të rrezikut për territorin e komunës së Rahovecit	NRP-02-1515-2022
6	Vendim-Naser Dula nga Rahoveci, i vazhdohet marrëdhënia e punës në pozitën e drejtorit të SHUM "Faik Sylka" në Rahovec.	NRP-02-1519-2022
7	Vendim formohet komisioni për vlerësimin e dëmit në "Shtëpinë e të moshuarve" në Rahovec	NRP-02-1520-2022
8	Vendim për caktimin e grupit punues për hartimin e Rregullores për dhënie e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe dekoratave të Komunës së Rahovecit	NRP-02-1521-2022
9	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për ndihma momentale për vitin 2022	NRP-02-1523-2022
10	Vendim për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Rahovecit, z. Kujtim Dina nga Rahoveci	NRP-02-1531-2022
11	Vendim për qasje në dokumente publike- OJQ-INPO	NRP-02-1542-2022
12	Vendim për lejimin e udhëtimit zyrtar dhe tërheqjen e avansit	NRP-02-1548-2022
13	Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me NR.Prot. 02/505/2021, i datës: 21.05.2021 për caktimin e grupit punues për përgatitjen e Strategjisë kundër dhunës në familje	NRP-02-1555-2022
14	Vendim-me këtë vendim lejohet ekzekutimi i mjeteve financiare për z. Asllan Mazreku- Menaxher i aseteve pranë Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit	NRP-02-1559-2022
15	Vendim miratohet kërkesa OVL-UÇK-së, Rahovec, me nr.prot.371, të dt. 3.2.22	NRP-02-1562-2022
16	Vendim për shfuqizimin e vendimit Nr. 02/1548/22, i dt. 14.02.2022	NRP-02-1566-2022
17	Vendim për caktimin e komisionit për pranimin e shërbimeve sipas kontratës: "Bartja e nxënësve në relacionet për vitin shkollor 2021/ 2022".	NRP-02-1567-2022
18	Vendim për caktimin e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale në Komunën e Rahovecit-z Agim Hoti	NRP-02-1568-2022

19	Vendim për qasje në dokumente publike-miratohet kërkesa për qasje në dokumente publike nga z.Arif Morina-avokat	NRP-02-1574-2022
20	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për Arsim për vitin akademik 2021/2022	NRP-02-1577-2022
21	Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për tërheqjen e Petty Cash-it	NRP-02-1578-2022
22	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e automjeteve	NRP-02-1587-2022
23	Vendim për caktimin e zyrtarit-es përgjegjës për regjistrimin dhe administrimin e kërkesave për banim social	NRP-02-1588-2022
24	Vendim për lejimin e kompenzimit të pagesës shtesë për punë jashtë orarit për z. Astrit Mullabazi.	NRP-02-1592-2022
25	Vendim për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë-miratohet pjesërisht e bazuar kërkesa për pushim pa pagesë e z. Bylbyl Hoxha-Zyrtar për vlerësimin e pronës pranë DBF	NRP-02-1594-2022
26	Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënien në shfrytëzim më pak se një(1) vit të pronës së paluajtshme të komunës për drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Rural	NRP-02-1596-2022
27	Vendim për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen dhe përcjelljen e realizimit të shërbimeve	NRP-02-1597-2022

Rahovec, shkurt 2022



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 10 të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës me 01Nr.197/21 të datës 8.05.2021, nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË (1) VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËR DREJTORINË PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

1. **Caktohet komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, në përbërje prej:**
 - 1.1 Diellza Çanta, kryesuese
 - 1.2 Shpejtim Mustafa, anëtar
 - 1.3 Venhar Topalli, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin e kërkesave për dhënie në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryej duke u bazuar në Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës me 01Nr.197/21, të datës: 08.05.2021 dhe duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet :

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,
3. Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 1510 Nr. i faq./Br.str./No.pg 315

Data/Datum/Date 1 / 2 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës 25.05.2016 dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr.02/1480, i datës: 24.01.2022

1. Me këtë vendim **shfuqizohet** vendimi Nr. 02/1480, i datës: 24.01.2022 për caktimin e ushtrueses së detyrës Drejtoreshë e Qendrës për Punë Sociale në Rahovec.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- znj. Ylfete Kryeziu,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Qendrës për Punë Sociale, dhe
- Arkivit.

Smail Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

FIKT NUKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I ARRIETARITTT KOMUNËS/KABINETI PRESIDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1511 Nr. i f. / No.pg 315
Data/Datum/Date 1
RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenin 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim znj. **Ylfete Kryeziu**, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Udhëheqëse e skemës së ndihmës sociale, pranë Qendrës për Punë Sociale në Rahovec, **autorizohet** që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme në ushtrimin e pozitës së drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Rahovec deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit dhe zgjedhjes së drejtorit sipas konkursit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr. protokolli 02/1347/21, i dt. 20.12.2021.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe stafi i Qendrës për Punë Sociale në Rahovec.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh se drejtori i Qendrës për Punë Sociale në Rahovec ka dhënë dorëheqje, vendi i punës së Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Rahovec është i lirë (vakant).

Për këtë arsye, duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve në Qendrën për Punë Sociale në Rahovec, pas administrimit të të gjitha provave u vendos që të autorizohet znj. Ylfete Kryeziu, nga fsh. Xërxë, komuna e Rahovecit, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Udhëheqëse e skemës së ndihmës sociale pranë Qendrës për Punë Sociale në Rahovec, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme në ushtrimin e pozitës së drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Rahovec sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Vendimi u dërgohet:

- znj. **Ylfete Kryeziu**,
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale**,
- **Qendrës për Punë Sociale në Rahovec**, dhe
- **Zyres së Përsoneelit**,
- **Arkivit**.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 8 paragrafi 1 pika 1.3, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e këshillit organizues për 17 Shkurtin - Ditën e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës

1. Caktohet këshilli organizues për 17 Shkurtin-Ditën e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:
 - 1.1 Fatmir Iska, kryesues
 - 1.2 Defrim Kafexhiu, anëtar
 - 1.3 Afrim Dina, anëtar
 - 1.4 Avni Morina, anëtar
 - 1.5 Nazmi Bellaqa, anëtar OVL-UÇK
 - 1.6 Nora Boshnjaku, anëtare
 - 1.7 Fehmi Isma, anëtar SHFD – UÇK
 - 1.8 Dervish Çadraku, anëtar
 - 1.9 Blerta Gashi, anëtare
 - 1.10 Shadat Ukaj, anëtar
 - 1.11 Qëndresa Duraku, anëtare
 - 1.12 Naser Dula, anëtar
 - 1.13 Muharem Morina, anëtar
 - 1.14 Qemajl Krasniqi, anëtar
 - 1.15 Ejup Kabashi, anëtar SHIL-UÇK.
 - 1.16 Naim Kafexhiu, anëtar
2. Këshilli organizues për 17 shkurtin, Ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës, ka për detyrë të shpërndajë ftesat për grupe dhe individë të rëndësishëm, të bëjë ndarjen e mirënjohjeve, seleksionimin e grupeve artistike pjesëmarrëse, të bëjë rregullimin e skenës dhe vendit ku do të zhvillohen aktivitetet, të ndërmerret të gjitha veprimet organizative për mbarëvajtjen e kësaj feste.
3. Organizimi dhe ndarja e përgjegjësiave për pjesën operative të ditës së shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, 17 Shkurtit i takon kryesuesit të këshillit organizues.
4. Obligohet këshilli organizues që të hartoj raport të detajuar për Kryetarin e Komunës mbi mbarëvajtjen dhe shpenzimet e organizimit të 17 Shkurtit, Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryesuesi dhe të gjithë anëtarët e këshillit organizues.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e këshillit organizues, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovač/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA RAHOVEC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PRESIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 1515 Nr. i faq./Br.str./No. pg 316

Data/Datum/Date 21.2.22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për hartimin e Planit të vlerësimit të rrezikut për territorin e komunës së Rahovecit

1. **Caktohet grupi punues për hartimin e Planit të vlerësimit të rrezikut për territorin e komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:**
 - 1.1 Përparim Krasniqi, kryesues
 - 1.2 Beqir Hamza, anëtar
 - 1.3 Blerta Gashi, anëtare
 - 1.4 Skender Hamza, anëtar
 - 1.5 Ilir Haxhijaha, anëtar
 - 1.6 Haziz Krasniqi, anëtar
 - 1.7 Albtor Mullaabazi, anëtar
 - 1.8 Shpejtim Mustafa, anëtar
 - 1.9 Afrim Dina, anëtar
 - 1.10 Qemajl Krasniqi, anëtar
 - 1.11 Berat Duraku, anëtar
 - 1.12 Jeton Kryeziu, anëtar
 - 1.13 Erhan Morina, anëtar
 - 1.14 Fidan Hoti, anëtar
 - 1.15 Besnik Hoti, anëtar
 - 1.16 Neki Krasniqi, anëtar
 - 1.17 Ylfete Kryeziu, anëtare
 - 1.18 Saranda Sallteku, anëtare
 - 1.19 Elbunit Kryeziu, anëtar
 - 1.20 Afrim Oruqi, anëtar
 - 1.21 Nora Boshnjaku, anëtare
 - 1.22 Valon Hoti, anëtar
 - 1.23 Sami Boshnjaku, anëtar
 - 1.24 Njazi Sokoli, anëtar
 - 1.25 Afrim Limani, anëtar
 - 1.26 Esat Hoti, anëtar
 - 1.27 Behar Berisha – KEDS, anëtar
 - 1.28 Jeton Kadiri - KRU “Gjakova”, anëtar
 - 1.29 Mentor Velu – “Ekoregjioni”, anëtar
2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Planin e vlerësimit të rrezikut për territorin e komunës së Rahovecit.

3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Grupi punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë me datë 15 mars 2022.
5. Obligohet grupi punues që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Planit të vlerësimit të rrezikut për territorin e komunës së Rahovecit.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- ***Anëtarëve të grupit punues,***
- ***Arkivit.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1519 Nr. i faq./Br.str./No.pg 316
Data/Datum/Date 3 12 2022
Kryetari i Komunës / Mayor

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008) nenit 7 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 të datës 01.12.2010, neni 35 të Ligjit 04/L-32 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.17/2001, neni 5 shkronja (d) të Ligjit për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 18 paragrafi 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.106 të datës 17.09.2020 për vlerësimin e performancës së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucioneve publike arsimore parauniversitare, nenit 9 të Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit dhe zëvendës drejtorit për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik, edukative-arsimore dhe aftësuese parauniversitare në Republikën e Kosovës procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të Kontratës dhe emërimit të përkohshme të datës 25.02.2014, nenit 74 dhe nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr.1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

1. **Naser Dula** nga Rahoveci i lindur 22.04.1968 me Nr.ID: 1007860826, i vazhdohet marrëdhënia e punës në pozitën e drejtorit të SHUM "Faik Sylka" në Rahovec.
2. **I ripërtërihet kontrata e re e punës** për periudhën kohore 4 (katër) vjeçare, me koeficient 7.8, duke filluar nga data 02.02.2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec.

Arsyetim

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit të jashtëm të performancës të drejtorit të shkollës me nr.reference: 10 Nr.pro.1253, të datës: 10.12.2021, raportit përmbledhës të vlerësimit të performancës të drejtorit të shkollës me nr. reference:10 Nr.protok.1254, të datës: 10.12.2021 dhe vendimin për performancë të drejtorit të shkollës me nr. reference: 10, nr.prot.1255, të datës: 10.12.2021 dhe rekomandimeve të bëra nga inspektorët e arsimit gjatë vlerësimit të performancës së drejtorit të SHUM "Faik Sylka" në Rahovec, z.Naser Dula nga Rahoveci i lindur 22.04.1968 me Nr. ID1007860826, i ripërtrihet kontrata e re e punës për periudhën kohore 4 (katër) vjeçare, me koeficient 7.8, në pozitën e drejtorit të SHUM "Faik Sylka" në Rahovec.

Duke u mbështetur në rregullativën në fuqi, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në Komisionin e ankesave për nënpunësit e shërbimit publik në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi.

Vendimi u dorëzohet:

- **Naser Dulës, nga Rahoveci,**
- **Drejtorisë Komunale të Arsimit, dhe**
- **Arkivit.**

Smaj Latif
Kryetari i Komunës

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E RAHOVECI
KRYETARI I KOMUNËS
II
RAHOVEC
ORAHOVAC
OPŠTINA RAHOVEC
MUNICIPALITY RAHOVEC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/ Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Preshednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1526 Nr. i faq./Br. str./No. pg 316
Data/Datum/Date 3 / 2 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për vlerësimin e dëmit në “Shtëpinë e të moshuarve” në Rahovec, në përbërje prej :
 1. Fidan Hoti, kryesues
 2. Asllan Mazreku, anëtar
 3. Izet Morina, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë vlerësimin e dëmeve materiale të shkaktuara.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryej duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport të detajuar me shkrim për drejtorinë dhe Kryetarin e Komunës.
5. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

1. Anëtarët e komisionit,
2. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
3. Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E RAHOVECI/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESIEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No 1521	Nr. i faq./Br.str./No.pg 316
Data/Datum/Date 3 / 2 / 22	
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e grupit punues për hartimin e Rregullores për dhënien e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe dekoratave të Komunës së Rahovecit

1. **Caktohet grupi punues për hartimin e Rregullores për dhënien e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe dekoratave të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:**
 - 1.1 Afrim Dina, kryesues
 - 1.2 Qemajl Krasniqi, anëtar
 - 1.3 Blerta Gashi, anëtare
 - 1.4 Skender Hamza, anëtar
 - 1.5 Mirsad Shala, anëtar
 - 1.6 Muharem Morina, anëtar
 - 1.7 Haziz Krasniqi, anëtar
2. Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Rregulloren për dhënien e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe dekoratave të Komunës së Rahovecit.
3. Obligohet grupi punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Grupi punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e grupit punues për dhënien e titujve të nderit, mirënjohjeve dhe dekoratave të Komunës së Rahovecit dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të grupit punues,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E ORAHOVAC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PRESIEDNIKA OPŠTINE/MAYOR'S CABINET	
Njësia Nr./Br./No	02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No	1523 Nr. i faq./Br.str./No pg 317
Data/Date	5 / 12 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC	

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 7 paragrafi 1 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Rahovecit Nr. 1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për ndihma momentale për vitin 2022

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për ndihmat momentale për vitin 2022, në këtë përbërje:
 - 1.1 Dr. Ardian Morina, kryesues
 - 1.2 Saranda Rama, anëtare
 - 1.3 Goneta Mustafa, anëtare
 - 1.4 Ekrem Bytyqi, anëtar
 - 1.5 Nazmi Bellaqa, anëtar nga shoqëria civile.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për ndihma momentale, për banorët rezident, për përballimin e shpenzimeve sipas kriterëve të parapara në nenin 21 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Rahovecit Nr. 1427 të datës 28.04.2017.
3. Obligohet komisioni që të veproj duke u bazuar në legjislacionin për financat publike dhe Rregullores Nr. 1427 të datës 28.04.2017 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve.
4. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarjen e subvencioneve.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- DSHPS, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Nr./Br./No. 1523 Nr. i fag./Br.str./No. pg. 317
Data/Datum/Date 4/2/22
P. HODONJO AJDARI

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 7 paragrafi 1 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Rahovecit Nr. 1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për ndihma momentale për vitin 2022

1. Caktohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për ndihmat momentale për vitin 2022, në këtë përbërje:
 - 1.1 Dr. Ardian Morina, kryesues
 - 1.2 Saranda Rama, anëtare
 - 1.3 Goneta Mustafa, anëtare
 - 1.4 Ekrem Bytyqi, anëtar
 - 1.5 Nazmi Bellaqa, anëtar nga shoqëria civile.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për ndihma momentale, për banorët rezident, për përballimin e shpenzimeve sipas kriterëve të parapara në nenin 21 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve të Komunës së Rahovecit Nr. 1427 të datës 28.04.2017.
3. Obligohet komisioni që të veproj duke u bazuar në legjislacionin për financat publike dhe Rregullores Nr. 1427 të datës 28.04.2017 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat për Ndarjen e Subvencioneve.
4. Anëtarët e komisionit për vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kriterëve për ndarjen e subvencioneve.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- DSHPS, dhe
- Arkivi.

Smail Latifi
Kryetari i Komunës
REPUBLICA E KOSOVES
KOMUNA E RAHOVECIT
OPŠTINA ORAHOVAC
MUNICIPALITY OF ORAHOVAC
PRESIDENT OF THE MUNICIPALITY



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KRYEQAJA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/RABOVIET PRILSDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 1531 Nr. i faq/Br.str/No.pg 317

Data/Datum/Date 8/2/22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 29 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.12 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim

1. **z. Kujtim Dina**, i lindur me datë: 02.01.1991 në Rahovec, me Nr. personal 1230466170 dhe me përgatitje profesionale Bachelor i Juridikut në Kolegjin "AAB" në Prishtinë, emërohet:

1.1 Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Rahovecit.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092, datë: 27.03.2015.
3. Ky emërim fillon nga data: **08.02.2022** dhe përfundon më datë: **30.04.2022**.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Të emëruarit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Zyrës së Personelit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

VENDIM

Për qasje në dokumente publike

2. Miratohet kërkesa me Nr. Prot. 446, e datës: 11.02.2022 për qasje në dokumente publike nga Valmir Ilazi-OJQ-INPO dhe i lejohet qasja në raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin fiskal 2021, duke përfshirë edhe kontratat e nënshkruara për punë shtesë gjatë vitin 2021 dhe vlera e tyre. Në përgjigje të përfshihet edhe raporti mbi aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2021 me titullin e aktivitetit dhe vlerën e parashikuar. Raporti i kontratave të nënshkruara duhet të jetë formular standard B53 i miratuar nga KRPP (forma Excel), përkatësisht, raporti duhet të jetë i njëjti që komuna është dashur ta dërgoj në KRPP deri më datë: 04.02.2022.

1. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesë me Nr. Prot. 446, e datës: 11.02.2022, nga Valmir Ilazi-OJQ-INPO për qasje në dokumente publike, përkatësisht qasje të plotë në raportin vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin fiskal 2021, duke përfshirë edhe kontratat e nënshkruara për punë shtesë gjatë vitin 2021 dhe vlera e tyre. Në përgjigje të përfshihet edhe raporti mbi aktivitetet e anuluar gjatë vitit 2021 me titullin e aktivitetit dhe vlerën e parashikuar. Raporti i kontratave të nënshkruara duhet të jetë formular standard B53 i miratuar nga KRPP (forma Excel), përkatësisht raporti duhet të jetë i njëjti që komuna është dashur ta dërgoj në KRPP deri më datë: 04.02.2022.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë **ELEKTRONIKE**.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimin të tij.

Vendimi u dergohet:

- **Haziz Krasniqi, Zyrtarit për shqyrtimin fillestar të QDP,**
- **Valmir Ilazi-OJQ-INPO dhe**
- **Arkivit.**

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF ORAHOVAC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S OFFICE

Njësia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No 1542 Nr. i faq./Br.st./No pg 314
Data/Datum/Date 14 / 2 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28-2008), Udhëzimit Administrativ Nr. MSHP 2004/07 për Udhëtimet Zyrtare, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kërkesës me Nr. Prot. 453 të datës 14.02.2022, Kryetari i Komunës merr këtë:


V E N D I M

Për lejimin e udhëtimit zyrtar dhe tërheqjen e avansit

1. Me këtë vendim **z. Ekrem Bytyqi**, Udhëheqës i sektorit për buxhet dhe financa, pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit, **i lejohet udhëtimi zyrtar.**
2. **z. Ekrem Bytyqi** do të marrë pjesë në seminarin mbi menaxhimin e buxhetit sipas rregullave të Ministrisë për Financa i cili do të mbahet në Republikën e Shqipërisë nga data 17 shkurt deri me datë 20 shkurt 2022.
3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i lejohet tërheqja e avansit për udhëtim zyrtar në shumën prej 490.00€ (katërqind e nëntëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe akomodimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

1. **z. Ekrem Bytyqi,**
2. **Drejtoria për Buxhet dhe Financa,**
3. **Njësia e Personelit, dhe**
4. **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/505/21, i datës: 21.05.2021 për caktimin e grupit punues për përgatitjen e Strategjisë kundër dhunës në familje

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/505/21, i datës: 21.05.2021 për caktimin e grupit punues për përgatitjen e Strategjisë kundër dhunës në familje në Komunën e Rahovecit.
2. Pika 1 e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:
 - 1.10 Lendrit Qeli, anëtar
 - 1.11 Antigona Morina, anëtare
 - 1.12 Vjollca Gurgule, anëtare nga Shoqëria Civile
 - 1.13 Adelina Shabani, anëtare nga Shoqëria Civile
3. Pika 2 e vendimit bazik ndryshohet dhe formulohet si në vijim:
 - 3.1 Grupi punues ka për detyrë që të përgatisë dhe të hartojë Strategjinë kundër dhunës në familje në Komunën e Rahovecit si dhe Planin e veprimit të kësaj strategjie.
4. Pikët tjera të vendimit bazik me numër Nr. 02/505/21, i datës: 21.05.2021 mbesin të pandryshuara.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me vendimin Nr. 02/505/21, i datës: 21.05.2021 është caktuar grupi punues për përgatitjen e Strategjisë kundër dhunës në familje në Komunën e Rahovecit.

Duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve si dhe nevojën e përfshirjes së zyrtarëve të tjerë të drejtorive dhe njësive të ndryshme në kuadër të administratës së Komunës së Rahovecit si dhe përfshirjen e shoqërisë civile, është e domosdoshme ndryshimi dhe plotësimi i vendimit bazik me Nr. Prot. 02/505/21, i datës: 21.05.2021 për caktimin e grupit punues për përgatitjen e Strategjisë kundër dhunës në familje në Komunën e Rahovecit.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi u dërgohet:


- Anëtarëve të grupit punues, dhe
- Arkivit.

 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDENATA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No 1555	Nr. i faq./Br./str./No.pg 310
Data/Datum/Date 15/7/22	
RAHOVEC / ORAHOVAC	





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Nr. 929/2021 i datës 07.12.2021, Aktvendimit 01 Nr. 1360 i datës 03.04.2013, Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit 01 Nr. 1362 i datës 03.04.2013, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim **lejohe**t ekzekutimi i mjeteve financiare për z. Asllan Mazreku, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Menaxher i aseteve pranë Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit me Aktvendimin 01 Nr. 1360, i datës: 03.04.2013 si dhe Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit 01 Nr. 1362, i datës: 03.04.2013, nga data 07.12.2021 siç parashihet me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Nr. 929/2021 i datës 07.12.2021.
2. Kërkojmë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, respektivisht Departamenti i Thesarit të Kosovës që të bëjë implementimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Nr. 929/2021, i datës: 07.12.2021 dhe të bëjë ndryshimin e koeficientit të pagës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 07.12.2021, ka marrë vendim dhe ka aprovuar pjesërisht ankesën e z. Asllan Mazreku, për pagesën e ndryshimit të koeficientit të pagës sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktemërimit nga data e pranimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Nr. Prot. 5857/21, i datës: 07.12.2021.

Duke marrë parasysh se Komuna e Rahovecit e ka të miratuar buxhetin për vitin 2021, autorizohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, respektivisht Departamenti i Thesarit të Kosovës që të bëjë implementimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Nr. 929/2021, i datës: 07.12.2021 dhe të bëjë ndryshimin e koeficientit, sipas Aktvendimit 01 Nr. 1360, i datës: 03.04.2013 dhe Ndryshimit dhe Plotësimit i Aktit të Emërimit 01 Nr. 1362, i datës: 03.04.2013.

Komuna e Rahovecit e ka të miratuar buxhetin për vitin 2022 nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit dhe në këtë buxhet Komuna e Rahovecit ka mjete të mjaftueshme për të bërë pagesën e

ndryshimit të koeficientit, siç parashihet në vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për z. Asllan Mazreku.

Për këtë arsye, pas administrimit të të gjitha provave dhe fakteve në shkresat e lëndës si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Nr. 929/2021, i datës: 07.12.2021, në cilësinë e Zyrtarit Kryesor Administrativ kërkoj nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, respektivisht Departamenti i Thesarit të Kosovës të bëjë implementimin e këtij vendimi dhe të bëhet ndryshimi i koeficientit të pagës nga koeficienti 7 (shtatë) në 7.5 (shtatë pikë pesë) dhe njëkohësisht të bëhet pagesa e ndryshimit të koeficientit nga data: 07.12.2021, siç parashihet në vendimin e KPMSHCK-së.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- ***KPMSHCK-së,***
- ***Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Njësisë së Personelit në Komunën e Rahovecit, dhe***
- ***Arkivit.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës – Presednik Opštine

Mayor Office
KOMUNA RAHOVEC / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA ORAHOVAC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetaris të Komunës)
Nr./Br./No 1562 Nr. i faq./Br.str./No.pg 321
Data/Datum/Date 16/ 2 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë :

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Rahovec, me nr. prot. 371, të dt. 03.02.2022.
2. OVL- UÇK-së, i ndahen 50 litra naftë për zhvillimin e aktiviteteve për manifestimet dhe përvjetorët (homazhe) për muajin shkurt.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

U dërgohet :

- OVL-së,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVCIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIDENTI RA O PŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1566 Nr. i faq./Br.str./No.pg 321
Data/Datum/Date 18.11.22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës 25.05.2016 dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, të datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit Nr. 02/1548/22, i datës: 14.02.2022

1. Me këtë vendim **shfuqizohet** vendimi Nr. 02/1548/22, i datës: 14.02.2022 me të cilin i është lejuar udhëtimi zyrtar dhe tërheqja e avansit në shumën prej 490€ (katërqind e nëntëdhjetë euro) për z. Ekrem Bytyqi, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Udhëheqës i sektorit për buxhet dhe financa pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset z. Ekrem Bytyqi dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- z. Ekrem Bytyqi,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Njesisë së Personelit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES/KABINETI I PRESIDENTIT OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës
Nr./Br./No 1567 Nr. i faq/Br.str/No.pg 321
Data/Datum/Date 18.2.22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2018), nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, të datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për pranimin e shërbimeve

1. Caktohet komisioni për pranimin e shërbimeve sipas kontratës: “**Bartja e nxënësve në relacionet për vitin shkollor 2021/2022**”, me Nr. identifikues: 623-21-5103-2-2-1, në këtë përbërje:
 - 1.1. Admirim Durguti, kryesues
 - 1.2. Luan Sharku, anëtar
 - 1.3. Samir Hasku, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë pranimin e shërbimeve sipas kontratës “**Bartja e nxënësve në relacionet për vitin shkollor 2021/2022**”, me Nr. prokurimi: 623-21-5103-2-2-1.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Arsim në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komisionit dhe Zyra e Prokurimit dhe Drejtoria për Arsim.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Arsim,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNES / ABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR / COUNCIL

Ndësia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës

Nr./Br./No 1568 Nr. i faq./Br.str./No.pg 321

Data/Datum/Date 18.12.22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 37 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale në Komunën e Rahovecit

1. **z. Agim Hoti**, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar i lartë për punë të Kuvendit dhe komiteteve në Kuvendin Komunal, pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit, **CAKTOHET:**

1.1. Zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale në Komunën e Rahovecit.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale në Komunën e Rahovecit janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Obligohet i lartpërmenduri që të veproj duke u bazuar në Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- **z. Agim Hoti,**
- **Agjencisë për Informim dhe Privatësi,**
- **Njesisë së Personelit, dhe**
- **Arkivit.**

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës
RAHOVEC / ORAHOVAC
OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNES / PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR / COUNCIL



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për qasje në dokumente publike

2. **Miratohet** kërkesa me Nr. Prot. 505, e datës: 18.02.2022 për qasje në dokumente publike nga Arif Morina-avokat i Feim Danës dhe i ofrohet qasje e **lejuar** në vendimin e drejtorisë së arsimit të komunës së Rahovecit mbi transferimin e mësimdhënësit Blerta Duraku nga një shkollë tjetër në SHFMU “Bajram Curri” në Krushë të Madhe në lëndën Biologji-Kimi.
1. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 505, e datës: 18.02.2022 nga Arif Morina-avokat i Feim Danës për qasje në dokumente publike, përkatësisht qasje të **plotë** në vendimin e drejtorisë së arsimit, të komunës së Rahovecit, mbi transferimin e mësimdhënësit Blerta Duraku nga një shkollë tjetër në SHFMU “Bajram Curri” në Krushë të Madhe në lëndën Biologji-Kimi.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë **ELEKTRONIKE**.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimi të tij.

Vendimi u dergohet:

- **Haziz Krasniqi, Zyrtarit për shqyrtimin fillestar të QDP,**
- **Arif Morina-Avokat i Feim Danës dhe**
- **Arkivit.**

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E RAHOVECI / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)	
Nr./Br./No 1574	Nr. i faq./Br.str./No.pg 322
Data/Datum/Date 22 / 2 / 22	
RAHOVEC / ORAHOVAC	





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA OF KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PRESIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 1577 Nr. i faq./Br.str./No.pg 322

Data/Datum/Date 22 / 2 / 22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Duke u bazuar në nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5, 7 dhe 8 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr.1427 e datës 28.04.2017, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Konkursin e hapur nga Drejtoria për Arsim Nr. 04 Nr. 1062 të dt. 17.01.2022, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për arsim për vitin akademik 2021/2022

1. **Caktohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për arsim për vitin akademik 2021/2022, në këtë përbërje:**
 - 1.1 Jeton Krasniqi, kryesues
 - 1.2 Qemajl Krasniqi, anëtar
 - 1.3 Arta Kabashi, anëtare
 - 1.4 Mirsad Shala, anëtar
 - 1.5 Nazmi Bellaqa, anëtar nga shoqëria civile
2. Caktimi i komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për arsim bëhet në përputhje me nenin 7 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427, e datës: 28.04.2017 dhe konkursit të hapur nga Drejtoria për Arsim 04 Nr. 1062, të datës: 17.01.2022.
3. Obligohet komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për ndarjen e bursave për arsim të veproj duke u mbështetur në Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427, e datës: 28.04.2017 dhe konkursit të hapur nga Drejtoria për Arsim 04 Nr. 1062, të datës: 17.01.2022.
4. Komisioni do të filloj punën menjëherë dhe punët të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Arsim në Komunën e Rahovecit.
6. Vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Arsim, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
ORAHOVAC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI I PRESIDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1587 Nr. i faq./Br.str./No.pg 323
Data/Datumi/Date 24.2.22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e automjeteve

1. Caktohet komisioni për vlerësimin e automjeteve dhe kamionëve jashtë përdorimit në pronësi të Komunës së Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Sami Boshnjaku, kryesues
 - 1.2. Samir Hasku, anëtar
 - 1.3. Vehbi Jupa, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të konstatoj dhe të bëjë vlerësimin e automjeteve dhe kamionëve jashtë përdorimit në pronësi të Komunës së Rahovecit.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryej duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë deri me datë 28.02.2022.
5. Pas përfundimit të punëve komisioni do të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, nenit 57, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, dhe Kërkesës së Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. 780/22, e datës: 23.02.2022, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin zyrtarit/es përgjegjës (administrator) për regjistrimin dhe administrimin e kërkesave për banim social

1. znj. Goneta Mustafa, e sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtare për shërbime sociale, në Qendrën për Punë Sociale në Komunën e Rahovecit, **CAKTOHET**:

1.1. Zyrtare përgjegjëse (administratore) për regjistrimin dhe administrimin e kërkesave për banim social.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtares përgjegjëse (administratore) për regjistrimin dhe administrimin e kërkesave për banim social në Komunën e Rahovecit janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.
3. Obligohet e lartpërmendura që të veproj duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset znj. Goneta Mustafa, Qendra për Punë Sociale në Rahovec dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- znj. Goneta Mustafa,
- Divizioni i Banimit, MMPHI,
- Qendra për Punë Sociale,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E ORAHOVAC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINETI PRESIDENTIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1592 Nr. i fag/Br.str./No.pg 324
Data/Datum/Date 24. 2. 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 paragrafi 3 pika 3.1 i të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil Nr. 03/L-147 i datës 13.05.2010 dhe nenit 11 paragrafi 6 pika 6.1 i Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në paga dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e kompensimit të pagesës shtesë për punë jashtë orarit

1. Me këtë vendim **lejohe**t pagesa për punë shtesë jashtë orarit të punës për z. Astrit Mullabazi, i cili është në marrëdhënie pune në kohë të pa caktuar dhe i sistemuar në punë dhe detyra të punës Zyrtar për Financa pranë Drejtorisë për Administratë në Komunën e Rahovecit.
2. I lartpërmenduri ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe atë 30% shtesë të pagës bazë për orë të plotë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës.
3. Mjetet për pagesën e punës jashtë orarit të rregullt sigurohen nga kodi Paga dhe Mëditje.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe prodhon efekt juridik deri në marrjen e një vendimi tjetër.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve të krijuara në Njësinë e Prokurimit si dhe pas autorizimit të marrë nga Zyrtari Kryesor Administrativ për udhëheqjen e procedurave të prokurimit pranë Zyrës së Prokurimit në Komunën e Rahovecit, pas transferimit të përhershëm të Menaxherit të Prokurimit në KRPP, është e domosdoshme pagesa e punës shtesë jashtë orarit për të lartpërmendurin, për zhvillimin e procedurave të prokurimit në mënyrë sa më efektive.

Për këtë arsye, marrë parasysh se i lartpërmenduri është i obliguar që të punoj edhe jashtë orarit të rregullt të punës, për kryerjen e detyrave të punës është e domosdoshme pagesa për punës shtesë jashtë orarit të rregullt të punës.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Nëpunësit Astrit Mullabazi,
- Njësisë së Personelit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E ORAHOVËC / OPŠTINA ORAHOVA / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL COUNCIL

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1594 Nr. i faq./Br.sh./No.pg 324
Data/Datum/Date 25 / 2 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe kërkesës së z. Bylbyl Hoxha nga Rahoveci me Nr. Prot. 494, të datës: 18.02.2022, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien e pushimit nga puna pa pagesë

1. **Miratohet si pjesërisht e bazuar kërkesa për pushim pa pagesë e z. Bylbyl Hoxha nga Rahoveci, i lindur me datë: 04.04.1993 dhe me Nr. Personal 1232327827, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për vlerësimin e pronës, pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, respektivisht nga data: 01.04.2022 deri me datë: 30.09.2022.**
2. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Obligohet Zyrtari për paga në Komunën e Rahovecit që ta largoj nga lista e pagës z. Bylbyl Hoxha për periudhën e lartcekur.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Njësia e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

z. Bylbyl Hoxha nga Rahoveci, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Zyrtar për vlerësimin e pronës, pranë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit, ka parashtruar kërkesë me Nr. Prot. 494, të datës: 18.02.2022, me të cilën ka kërkuar pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Të njëjtit, kërkesa i është aprovuar pjesërisht dhe atë në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh pa pagesë, respektivisht nga data: 01.04.2022, deri me datë: 30.09.2022.

Kërkesën i lartpërmenduri e ka parashtruar pasi që në tetor të vitit 2021 bashkëshortja e tij ka lindur fëmijën ku i janë shfaqur sëmundjet, andaj e njëjta nuk është në gjendje të përkujdeset për fëmijën e posalindur e poashtu edhe për veten e saj.

Duke marrë parasysh se i lartpërmenduri është prind i fëmijës, i cili ka nevojë për përkujdesje dhe në të njëjtën kohë edhe bashkëshortja për shkak të sëmundjes së saj nuk është në gjendje të përkujdeset për

shëndetin e saj e as të fëmijës së posalindur, është e domosdoshme dhënia e pushimit mjekësor pa pagesë për z. Bylbyl Hoxha për përkujdesjen e shëndetit të bashkëshortes dhe të fëmijës së tyre.

Gjatë kësaj periudhe, të lartpërmendurit i pushojnë të drejtat dhe detyrat e marrëdhënies së punës, përveç të drejtës së rikthimit në pozitën e mëparshme pas kalimit të afatit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

Pas administrimit të të gjitha provave, duke u bazuar në nenit 40 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 14 të Rregullores (QRK) Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, është konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që zyrtari publik ta shfrytëzoj pushimin pa pagesë, për përkujdesjen e shëndetit të bashkëshortes dhe të fëmijës së tij.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- ***z. Bylbyl Hoxha, nga Rahoveci,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrtari për paga,***
- ***Njësia e Personelit, dhe***
- ***Arkivi.***





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES / KABINET PRESEDNIKA OPSTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1596 Nr. i faq./Br.str./No.pg 324
Data/Datum/Date 28/2/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 10 të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës me 01Nr.197/21 të datës 8.05.2021, nenit 63 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM MË PAK SE NJË (1) VIT TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS PËR DREJTORINË PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

1. Caktohet komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, në përbërje prej:
 - 1.1 Fidan Hoti , kryesues
 - 1.2 Asllan Mazreku, anëtar
 - 1.3 Arben Gashi, anëtar
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin e kërkesave për dhënie në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit.
3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryej duke u bazuar në Rregulloren për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të pronës së paluajtshme të Komunës me 01Nr.197/21, të datës: 08.05.2021 dhe duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet :

1. Anëtarëve të komisionit,
2. Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
3. Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetari i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINLET PRESIDENK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 597 Nr. i faq./Br.sht./No. pë 324

Data/Datum/Date 28.12.22

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) nenit 74 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për mbikëqyrjen dhe përcjelljen e realizimit të shërbimeve

1. Me këtë vendim caktohet komisioni për mbikëqyrjen dhe përcjelljen e realizimit të shërbimeve sipas kontratës **“Pastrimi dhe mbikëqyrja higjienike të objektit të Komunës së Rahovecit”**, në përbërje prej:

- 1.1 Neki Krasniqi, kryesues
- 1.2 Bukurie Çanta, anëtare
- 1.3 Ardian Rama, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë që të mbikëqyr dhe përcjell realizimin e shërbimeve të përcaktuara sipas kontratës **“Pastrimi dhe mbikëqyrja higjienike të objektit të Komunës së Rahovecit”**,
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryej duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni ka për obligim që për shërbimet-punën e kryer të hartoj një raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe një ekzemplar të raportit t’ia dorëzoj përfaqësueses së kompanisë N.SH.H. “ZONA PARK” me seli në Prizren.
5. Komisioni do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- Anëtarëve të komisionit,
- Arkivit.

Smail Latifi

Kryetari i Komunës

